DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-940/4
Data 18.12.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | **Smajl Latifi**, Kryetar i Komunës së Rahovecit<br>**Afrim Dina**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit | |
| **Kopje:** | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së | |
| **Përmes:** | | |
| **Nga:** | **Trim Berisha**, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL | Datë: 17/12/2020<br>Nr.020-940/2 |
| **Zyrtarët përgjegjës:**<br>**1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor**<br>**2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor** | **Venera Çerkini** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave<br>**Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Leonora Bajrami**, Zyrtare për monitorim të komunave | |
| **Lënda:** | Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë se aktit të Komunës së Rahovecit | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore 01-Nr.132/20,** miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament

4913/2
2+2
17.12.2020

HYRCE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 17.12.2020
UL- 020-940/2

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit<br>Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit | |
| Kopje: | Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL<br>Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave,<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave,<br>Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorimin të Komunave | |
| Përmes: | Besian Mustafa, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br><br>Bekim Hoxha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MBPZHR | |
| Nga: | Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor në MBPZHR | |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor në MBPZHR | 17.12.2020<br>Ref.10.118/20 |
| Lënda: | Vlerësimi i rregullt i ligjshmërisë | |
| Lloji i aktit: | Vendim për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit 01 Nr.132/20 të 30.11.2020 | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) NR.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë (QRK)-NR.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020) dhe Departamenti Ligjor i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (04.12.2020) ka

pranuar kërkesën për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr.132/20 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.<br><br>I miratuar më datë: 30.11.2020<br><br>I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 03.12.2020 |

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.</u>**

Kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore e propozuar me Vendim nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit 01 Nr.132/20 të dt. 30.11.2020, Njësia Kadastrale Nr. P-71510056-00062-3, Zona Kadastrale Opterushë - Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe prej 560m², kullosë e klasës gjashtë (6) pronë private në emër të Melit (Axhi) Bytyqi, është në kundërshtim me Nenin 11. paragrafi 11.2, dhe paragrafi 11.4 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.06.2007), në të cilin citohet:

Neni 11. Paragrafi 11.2. "Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj".

Neni 11 paragrafi 11.4. "Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të filloj të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër".

Arsyet e supozuara të shkeljes janë se Komuna e Rahovecit e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal nga viti 2013 (PZhK 2013-2023), të miratuar në qershor të vitit 2013, dhe parcela e lartcekur me veçoritë e saj, sipas këtij Plani (që buron nga Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor të Kosovës) është e planifikuar si tokë bujqësore, në të cilën nuk lejohet ndërtimi, pra gjendet jashtë zones ndërtimore, dhe rrjedhimisht nuk lejohet as ndërrimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e *Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*, mbetet në dispozicion të MPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

*Me respekt,*

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament

| | | |
|---|---|---|
| ZA: | Smajl Latifi, Gradonačelnik Opštine Orahovac<br>Afrim Dina, Presedavajući Skupštine Opštine Orahovac | |
| KOPIJA: | Trim Berisha, Zm. Generalni sekretar MLU<br>Venera Çerkini, Rukovodilac Pravnog Departmana i Monitoring - Praćenje Opština.<br>Xhevat Tafa, Rukovodilac Divizije za Monitoring Opština.<br>Leonora Bajrami, Zvaničnik za Monitoring Opština | |
| PREKO: | Besian Mustafa, Ministar Ministarstva Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja<br><br>Bekim Hoxha, Zm. Generalni Sekretar MPŠRR | |
| OD: | Isah Rudaku, Zm. Direktora Pravnog Departmana, MPŠRR | |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik za potvrđivanje pravne procjene<br>2. Službenik za izradu pravne ocene | Isah Rudaku, Zm. Direktora Pravnog Departmana, MPŠRR | 17.12.2020<br>Ref.10.118/20 |
| Predmet: | Redovna procena zakonitosti | |
| Vrsta akta: | Odluka o promeni odredišta poljoprivrednog zemljišta u građevinsko zemljište odobrena od Skupštine opštine Orahovac 01 br.132/20 od dt. 30.11.2020 | |

Poštovani gradonačalniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo (VRK) BR.10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade (VRK) -BR.06 / 2020 o oblastima administrativne odgovornosti

Kancelarije premijera i ministarstava (08.06.2020) i Pravnog Departmana Ministarstva poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja (04.12.2020) prihvatili su zahtev za obavezno preispitivanje zakonitosti, kako je predviđeno članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi, sledeći opštinski akt:

| |
|---|
| Odluka Skupštine opštine Orahovac 01 br.132/20 o promeni odredišta poljoprivrednog zemljišta u građevinsko zemljište.<br><br>Odobreno datuma: 30.11.2020<br><br>Predato na razmatranje u MLU datuma: 03.12.2020 |

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, nakon što je razmotrilo sadržaj opštinskog akta kao što je gore navedeno, ocenjuje da je opštinski akt **je u suprotnosti sa odredbama važećeg zakona.**

Zahtev za promenu namene poljoprivrednog zemljišta u građevinsko predložen odlukom Skupštine opštine Orahovac 01 br.132/20 od dt. 30.11.2020, katastarska jedinica Br. P-71510056-00062-3, katastarska zona Opteruša - opština Orahovac, na površini od 560m², pašnjak privatne imovine klase šest (6) na ime Melit (Axhi) Bytyqi, u suprotnosti je sa članom 11. stav 11.2, i stav 11.4 Zakona br.02/L-26 o poljoprivrednom zemljištu (Službeni list Republike Kosovo br.13/01.06.2007), u kojem se citira:

Član 11. stav 11.2."Promena odredišta poljoprivrednog zemljišta može se izvršiti samo u skladu sa planom prostorne regulacije i drugim odredbama određenim zakonom".

Član 11 stav 11.4."Poljoprivrednom zemljištu iz člana 10.5 (a) i (b) ne može se promeniti i ne može početi da se koristi u nepoljoprivredne svrhe, ako za taj region nije izdat prostorni plan, odnosno opštinski razvojni plan sa kojim je ovom zemljištu je određeno drugo odredište".

Predpostavljeni razlozi kršenja su jer opština Orahovac odobrila opštinski razvojni plan od 2013. godine (ORP 2013-2023), odobren u junu 2013. godine, i parcela gore navedena sa svojim karakteristikama, prema ovom planu (koji proizlazi od Zakona br.04/L-174 o prostornom planiranju Kosova) planirano je kao poljoprivredno zemljište, na kome nije dozvoljena gradnja, odnosno nalazi se izvan građevinskog područja, i shodno tome nije dozvoljena ni promena odredišta sa poljoprivrednog zemljišta u građevinsko zemljište.

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja, nakon što je razmotrilo sadržaj opštinskog akta kao što je gore navedeno, smatra da je opštinski akt **je u suprotnosti sa odredbama važećeg zakona** i kao takav može proizvesti pravne efekte.

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja ostaje na raspolaganju MPL-u i opštini za svako dalje pojašnjenje u vezi sa ovom procenom.
S poštovanjem,